



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 953/Prot.
3

Patos, më 08.04.2024

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes jashtë radhe së Këshillit Bashkiak Patos.

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Patos.

Për dijeni: Prefektit të Qarkut Fier.

Kryetarit të Bashkisë Patos.

Në zbatim të nenit 53 pika 3 gërma "a" të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të nenit 59 të "Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin të Këshillit Bashkiak", ju njoftojmë se **ditën e martë, datë 16.04.2024, ora 11⁰⁰**, në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Patos do të zhvillohet mbledhja jashtë radhe e Këshillit Bashkiak Patos, me këtë rend dite:

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.03.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.03.2024.
- 4- Projekt-vendim "Mbi miratimin e shërbimit të transportit publik të linjës Patosi i Ri- Mustafa Matohiti-Margëlliç me mjete transporti të bashkisë, miratimin e vlerës së biletës si tarifë për mbulimin e shërbimit me mjete transporti".
- 5- Projekt-vendim "Për miratimin e projektit të rikonstruksionit të rrugës "Shën Trifoni" dhe "Shën Sotiri", Sheqishte".
- 6- Projekt-vendim "Për miratimin e procesverbalit standard, për efekt të përlllogaritjes së sipërfaqes së truallit, ndërtesës dhe hapësirës publike për bizneset në bashkinë Patos.
- 7- Projekt-vendim "Për miratimin e aktit të themelimit të shoqërisë së trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier nr. 916., prot datë 03.04.2024".

Komisioni i Shërbimeve Publike, Zhvillimi Urban, Ndërtimet dhe Pronat do të shqyrtojë pikën 4 dhe 5 dhe do të mblidhet në sallën e Këshillit Bashkiak, **ditën e hënë, datë 15.04.2024, ora 11:00.**

Komisioni i Ekonomisë, Financës dhe Ndhimave Ekonomike, do të shqyrtojë pikën 6 dhe do të mblidhet në sallën e Këshillit Bashkiak, **ditën e hënë, datë 15.04.2024, ora 13:00.**

Komisioni i Ligjeve, marrëdhëniet me komunitetin dhe jashtë do të shqyrtojë pikën 7 dhe do të mblidhet në sallën e Këshillit Bashkiak, **ditën e hënë, datë 15.04.2024, ora 14:00**



KRYETARI
Armand Ahmetaj

Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos